REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I PLANIFIKIMIT DHE PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE

Nr. 247/1 **Prot.** **Elbasan, më** 18.2.**2026**

Lënda: Konfirmim Akti.

KËSHILLIT TË BASHKISË LIBRAZHD

Adresa: Sheshi Gjorg Golemi

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr 107 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.23 datë 12.02.2026, Për "Miratimin e dokumentacionit tekniko ligjor dhe kompensimin financiar të subjektit privat "Restaurim Gurra-Kaca shpk" në bazë të marrëveshjes së lidhur me institucionin e bashkisë me nr.204 datë 13.01.2026 për situatën e krijuar nga bllokimi i rrugëve rurale nga dëbora dhe ngricat të Nj/A të bashkisë Librazhd në shumën 368,674.2", burimi i financimit nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për MC akorduar bashkisë Librazhd, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Ilir BEJTJA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË-PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

Lagjia:Brig. "17.Sulmuese", Rruga " Qemal Stafa" E-mail : prefekti.elbasan@mb.gov.al Tel: 054 25 21 38, Fax: 054 25 24 46

247
13.2.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM **Datë.13.02.2026**

Nr.902 prot

Nr.23 dt.12.02.2026

PËR MIRATIMIN E DOKUMENTACIONIT TEKNIKO LIGJOR DHE KOMPENSIMIN FINANCIAR TË SUBJEKTIT PRIVAT " RESTAURIM GURRA-KACA SH.P.K" NË BAZË TË MARRVESHJES SË LIDHUR ME INSTITUCIONIN E BASHKISË ME NR 204 DT.13.01.2026 PËR SITUATËN E KRIJUAR NGA BLLOKIMI I RRUGËVE RURALE NGA DËBORA DHE NGRICAT TË NJ/A TË BASHKISË LIBRAZHD.

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij date 12.02.2026 pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Sektori I Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar "Për dhënien e ndihmë financiare për Subjektin privat " Restaurim Gurra-Kaca sh p k Bashkia Librazhd bazuar në:

- Ligji nr 139/2015 " Për vetqeverisjen vendore"
- Ligji nr 45/2019 " Për Mbrojtjen Civile"
- Vkm nr 654 dt 1618.02.2002" Për përcaktimin e tarifave , për përdorim të përkohshëm nga organet shtetërore në situate emergjente të cdo mjeti privat."(si dhe Akt – Marrveshjet me nr 204 dt.13.01.2026.
- Vkb nr 110 dt 23.12.2025 "Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Librazhd për vitin 2026.

VENDOSI:

1. Të miratoj dokumentacionin tekniko-ligjor të përgatitur nga Sektori I Emergjencave Civile Bashkisë për situatën e krijuar nga dëbora dhe ngricat në teritorin e NJ/A-ve të Bashkisë Librazhd.

2. Të miratojë dhënien e ndihmës financiare në vlerën : 368 674.2 lekë sipas përllogaritjes në preventivat përkatës nga fondi I kushtëzuar I Buxhetit të Shtetit për MC akorduar Bashkisë Librazhd për vitin 2026.

3. Ndihma financiare llogaritet mbi bazën e procesevë të punës në cdo segment rrugor,orëve të punës sipas process-verbalit të menaxhimit të punimeve për cdo NJ/A si dhe të çmimeve sipas analizës së çmimeve të përdorur nga ARR SH (Për hedhje kripe në rrugë me asfalt).

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit,Menaxhimit dhe Shërbimit Social si dhe Sektori I EC.

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

SEKRETAR I KËSHILLIT
Elson MALLUTA

ZV/KRYETARE E KËSHILLIT
Silvana HOXHA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD